

VENDIM
Nr. 56, datë 5.12.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE NR. 11, DATË 10.3.2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhë vendimit nr. 11, datë 10.3.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për miratimin e financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim, të grantit “Shqipëria dixhitale”, programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla III, si dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 13, datë 25.2.2015, dhe vendimin nr.21, datë 16.3.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve”, bëhen ndryshimet, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar,
Ministri i Financave	anëtar,
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,	
Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar,
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar,
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar,
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar,
Ministri i Shëndetësisë	anëtar,
Ministri i Kulturës	anëtar,
Ministri i Mjedisit	anëtar,
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar,
Ministri i Shtetit për Inovacionin	
dhe Administratën Publike	anëtar,
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar,
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar,

Tabela 1. Ndryshim në vendimin nr.11, datë 10.3.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Projekteve nr.15 dhe 17, si më poshtë vijojnë, në tabelën 1, të këtij vendimi, në kolonën “Vlera e kontratës” dhe “Vlera e financimit për vitin 2016”, i bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vendimi i KZHR-së	Vlera e projektit (Lekë)	Vlera e kontratës (Lekë) / veprim korrektues (*)	Vlera e financimit për vitin 2015 (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 ishte (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 bëhet (në lekë)
15	Ministria e Kulturës	Regjistrimi i Pasurive Kulturore Kombëtare në qendrat e regjistrimit fizik dhe <i>on-line</i>	Nr.29, dt.29.5.2015 nr.11, dt.10.3.2016	45 429 718	44 212 690	31 800 803	2 107 832	12 411 887
17	Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit	Shërbimet <i>on-line</i> të AQTN-së dhe shkëmbimin dixhital të informacionit me entet publike (Integrimi i 5 shërbimeve në platformën e-albania)	Nr.33, dt.15.7.2015 nr.11, dt.10.3.2016	96 847 825	83 848 222	58 108 695	11 764 823	25 739 527
TOTAL				142 277 543	128 060 912	94 679 498	13 872 655	38 151 414

Shënim:

- Veprimi i korrektues i vlerës së kontratës bëhet pasi vlera e deklaruar më parë nga autoriteti kontraktues nuk përfshinte vlerën e TVSH-së. Kjo vlerë e ndryshuar nuk e kalon vlerën e plotë të projektit, të miratuar më vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Korrektimi i vlerës së kontratës bëhet me kërkesë të sekretariatit teknik pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, nr.4543/1 prot, datë 6.9.2016.
- Totali i vlerës së kontratës, për tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.11, datë 10.3.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhet si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (lekë)	Vlera e kontratës (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)
TOTALI			2 168 075 141	1 789 303 490	1 471 127 752	327 588 989

